

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Muli i kënaqur nga shpjegimet e Doktorit për 6 milionë dollarët e vizës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/antena/muli-i-kenaqur-nga-shpjegimet-e-doktorit-per-6-milione-dollar-et-e-vizes-i586935
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 16:09:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 16:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9c3a8421c698d73eb584cc770a39964c2adbd2cb00466a220788c50d241b79a6
TEKSTI	0cf7b902fa03c58fc9f7a8d595b5041d1b7af77837332e6dcb676f0ca1d52c9
PAMJA	9a549c366ee707ebf5ef9b854e19e35128f59e56d471587e55519d4f9e4bb2eb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2767ea704c973874ec53da633f5d0806ce954c179b070499121518e044f2081a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	01dec896a9f5048ec789d11efc6a4c6ac149c2dbc9d9f31c517f24c69c93634b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2767ea704c973874ec53da633f5d0806ce954c179b070499121518e044f2081a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

18 Shtator 2026, 18:06Antena TEMA

Muli i kënaqur nga shpjegimet e Doktorit për 6 milionë dollarët e vizës



18 Shtator 2026, 18:06Antena TEMA

Pas intervistës së djeshme të Doktorit në “Opinion”, Muli është më i qetë. Doktorit e shpjegoi qartë se 6 milionë dollarët për avokatët që i siguruan vizën i ka paguar një biznesmen tropojan në SHBA, të cilin nuk do ta identifikojë, por, për lehtësi komunikimi, po e quajmë me pseudonimin “Valbona”. Pastaj, marrëdhëniet publike për këtë ia ka mbuluar një tjetër personalitet nga Tropoja, të cilit, për lehtësi, po i vëmë pseudonimin “Shkëlzeni”.

Këta të dy kanë operuar financiarisht dhe në rrugë diplomatike që lekët të mbërrinin në vendin e duhur dhe Doktorit të merrte vizë, edhe pse nuk iu hoq “non grata”.

– Unë shpëtova, – i tha Lelos. – Tani “Valbona” dhe “Shkëlzeni” të bëjnë ç’të duan. Doktorit më nxori nga sikleti që i kam nisur unë lekët nga PD-ja. Sa të jetë Trumpi, nuk ua mban këtyre të SPAK-ut të hetojnë këtu. Malin e Tiranës edhe mund ta hetojnë, por dërgesat e mia nga PD-ja s’i prekin dot, se s’kanë bythë.

– Ky është lajm i mirë, – tha Lelo. – Tani edhe “La Civita” ka marrë 6 milionë dhe ata të tjerët kanë marrë 6 milionë? Si i bie kjo?

– Nuk e di, por ne 6 milionë kemi shpallur kontratën e “La Civita”-s, por ajo që për fushatë. Ai e bëri të vetën, na e nxori në telefon atë gruan që e uruam nga mitingu. Nuk është pak ajo. Kurse ky 6-milionëshi tjetër është punë e “Valbonës” dhe “Shkëlzenit”.

– E kuptova, – tha Lelo. – Domethënë, kjo nuk i dihet sa është fiks, por, sado të jetë, ia ka vlejtur. Të paktën tani Doktorit vdes i qetë, se e takoi edhe një herë Ludovikun në Teksas.

– Kjo është e vërtetë, – tha Muli. – Të gjithë atë ëndërronim. Të shkelte edhe një herë ai burrë në SHBA. Pastaj s’duam as pushtet, as bukë, as ujë.

– Këtë mos e thuaj më, – tha Lelo, – se na ikin edhe këta të Foltres që kanë mbetur. Tani duhet thënë që Doktorit do të shkojë çdo tre muaj në SHBA, se do të bëjë letrat të vdesë atje. Vetëm kështu mund t’i mobilizojmë. Por puna është se s’i kanë dhënë vizë Teta Lilit dhe nuk rri dot vetëm.

– Do ta rregullojmë edhe atë, – tha Muli. – Tani që e morëm vesh sa lekë duhen, nuk ka gjë që s’bëhet.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Muli në dilemë për deklaratat e Doktorit për Gjykatën e Hagës

19:18 Antena / 4 komente

Muli i paqartë si duhet të reagojë për Thaçin

20:21 Antena / 7 komente

Muli xheloz për flamingon e ri nga Pekaj

19:19 Antena / 2 komente

Muli zbulon enigmën e dështimit të mitingut të diasporës

16:36 Antena / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.